

KUR RICIKLOJMË TË GJITHË, FITOJMË TË GJITHË



Sa herë që depozitoni ambalazhe ose një gazetë për riciklim, ky është fillimi i **diçkaje të madhe.**

Kapakët e shisheve të vjetra mund të konvertohen në fletë të reja metali për trupin e makinave. Një kuti bosh e detergjentit të rrobave mundet për shembull të bëhet një kuti e re për picë. Gazeta e djeshme mund të mbajë titullin kryesor të së nesërme. Materialet e papërpunuara të natyrës përdoren sërish dhe kursehet shumë energji. Duke e bërë këtë, ne ndihmojmë në krijimin e një bote më të mirë në të cilën jetojmë.

RICIKLIMI

Të gjitha ambalazhet dhe gazetat që grumbullohen çohen për riciklim që të bëhen ambalazhime të reja ose produkte të reja. Ambalazhi plastik mund të bëhet material shtesë për shembull për qese plastike dhe paketime plastike të riciklueshme. Ambalazhi i qelqit dhe i letres zakonisht kthehet në ambalazhe të tjera. Ambalazhi prej metali mund të kthehet në pjesë të rrotave të makinave dhe gazetat e vjetra mund të bëhen letër kuzhine ose letër e re për gazetat.

PËRGJEGJËSIA E PRODHUESIT

Ne kemi një rregull në Suedi të quajtur përgjegjësia e prodhuesit. Kjo do të thotë se kompanitë që prodhojnë ose shesin ambalazhe janë përgjegjëse për grumbullimin dhe riciklimin e produkteve të tyre. Në Förpacknings- och Tidningsinsamlingen, FTI, ne punojmë në emër të këtyre kompanive. Ne duam ta bëjmë më të lehtë për ju që të ricikloni, e në të njëjtën kohë të maksimalizoni përfitimet mjedisore të riciklimit. Por ne na duhet ndihma juaj që t'ia dalim me sukses.

PIKAT E RICIKLIMIT

FTI-ja (Förpackningsinsamlingen) është përgjegjëse për të gjitha pikat pa personel të riciklimit nëpër Suedi. Këto janë vendet ku ju duhet të çoni gazetat dhe ambalazhet plastike, prej letre, metali dhe qelqi për riciklim. Nëse jetoni në një pallat me një pikë të përbashkët riciklimi, duhet që gazetat dhe ambalazhet t'i çoni atje.

MË SHUMË INFORMACION

Në www.fti.se/hitta-atervinningsstation mund të gjeni pikën më të afërt të riciklimit dhe të kontrolloni kur boshatiset dhe pastrohet. Këtu mund të gjeni edhe udhëzime sesi t'i ndani mbetjet, video mbi riciklimin dhe këshilla e informacione të tjera mbi organizatën tonë.

Nëse keni ndonjë pyetje rreth riciklimit të gazetave dhe ambalazheve, ju lutemi na kontaktoni nëpërmjet kontakt@ftiab.se ose na telefononi në numrin **08-566 144 00**. Për pyetje rreth mbetjeve me përmasa të mëdha, kompostimit, mbetjeve elektrike ose problemeve të tjera me mbetjet, ju lutemi kontaktoni autoritetin tuaj vendor ose lexoni më shumë në www.sopor.nu.

Kategorizoni më shumë

Për të bërë të mundur që të riciklohen sa më shumë mbetje, ne na duhet ndihma juaj. Ambalazhi duhet të jetë i boshatisur dhe i thatë. Nëse keni ambalazh të përbërë nga më shumë se një material, duhet ta kategorizoni në materialin që mendoni se peshon më shumë. [Ju faleminderit.](#)



AMBALAZHI PLASTIK

Për shembull: Shishet, kanoçet, qeset plastike, paketat rimbushëse, tubat plastike, paketat e patatinave dhe polistiroli.

- ✓ Hiqni çdo tapë ose kapak. Boshatisni qesen tuaj me llojet e ndryshme të ambalazhit plastik në enët e ndryshme për secilën. Kjo e bën më të lehtë punën në fazat e mëvonshme të riciklimit.
- ✗ Produktet e tjera plastike përveç ambalazhit duhet të kategorizohen si mbetje me përmasa të mëdha ose mbetje shtëpiake, p.sh. mobiliet dhe lodrat. Shishet e depozitimit duhet të kthehen në një dyqan për rimbursim.



AMBALAZHI PREJ LETRE

Për shembull: Kutitë e makaronave, të qumështit dhe lëngjeve, qeset prej letre, kutitë e këpucëve, tubat e letrës higjienike dhe kutitë prej kartoni.

- ✓ Sheshojini dhe palosini në dysh. Vendosini ambalazhet e vogla brenda ambalazheve të mëdha për të kursyer hapësirë.
- ✗ Zarfet duhen klasifikuar si mbetje shtëpiake ose mbetje shpërthyesë. Gazetat, fletëpalosjet e reklamave dhe sendet e ngjashme duhen depozituar në enët për gazetat.



AMBALAZHI PREJ METALI

Për shembull: Kanoçet, kanoçet e boshatisura të spërkatjes, tubat, kapakët e shisheve, kapakët dhe kutitë e boshatisura të bojës.

- ✓ Palosini brenda kapakët e mprehtë të kanoçeve prej metali.
- ✗ Kutitë që kanë mbetje boje ose ngjitësi duhet të kategorizohen si mbetje të rrezikshme. Mbetjet metalike, pjesët e mbetura të punimeve hidraulike dhe produktet e tjera që nuk janë ambalazhime, duhet të kategorizohen si mbetje me përmasa të mëdha ose mbetje shtëpiake. Kanoçet e depozitimit mund të kthehen në një dyqan për rimbursim.



AMBALAZHI PREJ QELQI

Për shembull: Shishet dhe kavanozat prej qelqi me ngjyrë ose të tejdukshëm.

- ✓ Hiqini kapakët e tapat dhe kategorizojini sipas materialit përkatës. Kategorizoni ambalazhin e qelqit me ngjyrë dhe të tejdukshëm në enën e duhur.
- ✗ Shishet depozituese duhen kthyer në një dyqan për rimbursim. Porcelani, qeramikat dhe produktet e tjera që nuk janë ambalazhim, duhen kategorizuar si mbetje me përmasa të mëdha ose shtëpiake. Llambat dhe neonet zakonisht duhen çuar në qendrat e riciklimit me personel të autoritetit vendor.



GAZETAT

Për shembull: Gazetat ditore dhe javore, revistat, katalogët, fletëpalosjet e reklamave, ditarët dhe letrat e shkrimit/vizatimit.

- ✓ Hiqni mbështjellësen prej plastike dhe etiketat e reklamimit.
- ✗ Zarfet dhe librat duhen klasifikuar si mbetje shtëpiake ose mbetje shpërthyesë. Qeset prej letre, kartonët dhe sendet e ngjashme duhen depozituar në enët për ambalazhin prej letre.